



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 173 Datë 24.12.2012

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT
TË SHOQËRISË “BALKAN GREEN ENERGY” SH.P.K PËR
KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES NGA HEC-ET
“ARRAS”, “FUNARES”, “DUKAGJIN”, NIKOLICE”, “BULQIZE”,
“LURE”, “ORGJOST”, “LEKBIBAJ”, “VELCAN”, “ZERQAN”,
“BORSH”, “LESHNICE”, “SHOSHAN”, “UJANIK”, “KERPICE”,
“BARMASH”, “LUNIK”, “HOMESH”, “MUHUR”, “RAJAN”,
“MARJAN” DHE “TRESKE 2” SI BURIME TË RINOVUESHME
ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “l”, 9 dhe 39 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 5 pika 8, 6; 7 dhe 8 të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 9, datë 21.02.2007; nenit 18 pika 1 gërma “d”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 21 datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 24.12.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC-et “Arras”, “Funares”, “Dukagjin”, “Nikolice”, “Bulqize”, “Lure”, “Orgjost”, “Lekbibaj”, “Velcan”, “Zerqan”, “Borsh”, “Leshnice”, “Shoshan”, “Ujanik”, “Kerpice”, “Barmash”, “Lunik”, “Homesh”, “Muhur”, “Rajan”, “Marjan” dhe “Treske 2”, si burime të rinovueshme energjie,

Konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**
Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.
Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.
- **Neni 7, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur ne mënyrë korrekte.

- **Neni 7 pika 3, gërmat “a“, “b“, “c“**

Përshkrimi i centralit..

Ky dokumentacion është dhënë i sakte dhe i plote.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi :

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k, për kualifikimin e impiantit prodhues nga HEC-et “Arras”, “Funares”, “Dukagjin”, “Nikolice”, “Bulqize”, “Lure”, “Orgjost”, “Lekbibaj”, “Velcan”, “Zerqan”, “Borsh”, “Leshnice”, “Shoshan”, “Ujanik”, “Kerpice”, “Barmash”, “Lunik”, “Homesh”, “Muhur”, “Rajan”, “Marjan” dhe “Treske 2”, si burime të rinovueshme energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI